



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:075610

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06640618

PAKR.nr.688/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi, kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.S nga Mamusha, për shkak të veprës penale, Falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe veprës penale, Hyrja e paautorizuar kompjuterike nga neni 277 par.2 të Ligjit nr.8/L-188, për plotësimin dhe ndryshimin e KPRK-së, lidhur me nenin 77 të KPRK-së nr.06/L-074, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit M.S, av. Forti Skoro, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.65/2024, të datës 30.09.2024, në seancën e kolegjit me datë 19.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.S, av. Forti Skoro, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.65/2024, i datës 30.09.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.65/2024, i datës 30.09.2024, të akuzuarin M.S e ka shpallur fajtor për veprat penale, Falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 427 par.1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, nr.06/L-074, dhe veprës penale, Hyrja e paautorizuar kompjuterike nga neni 277/D par.2 të Ligjit nr. 08/L-188

për plotësimin dhe ndryshimin e KPRK-së, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, nr.06/L-074, dhe e ka gjykuar si në vijim: për veprën penale në pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, më dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve, dhe për veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve. Në kuptim të nenit 76 par.1 dhe 2 nënpar. 2.2 të KPRK-së, të akuzuarit i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 22 (njëzet e dy) muajve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 05.03.2024 deri me datën 25.09.2024. Të akuzuarit i është ndaluar ushtrimi i funksioneve në administratën publike apo në shërbim publik, dhe atë në kohëzgjatje prej 5 vitesh, pas përfundimit të vuajtjes së dënimit me burgim. Vendimi është marrë në kuptim të nenit 62 par.3 të KPRK-së. Është urdhëruar anulimi i plotë i veprimeve juridike të kundërligjshme në drejtim të 124 personave të përshkruar sikurse në pikë I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, të cilët janë regjistruar në mënyrë të kundërligjshme, këtë është obliguar ta kryej ARC, që t'i shpallë të pavlefshme dokumentet e nxjerra në emër të Republikës së Kosovës për 124 personat e cekur në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke përfshirë certifikatat, letërnjoftimet dhe pasaportat. Këtë ARC është obliguar ta kryej në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të akuzuarit i është kthyer 1 (një) telefon Samsung: IMEI:xxx2, IMEI2:xxxxx. Pala e dëmtuar ARC (Agjensioni për Regjistrim Civil) Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

I akuzuari është obliguar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor është detyruar të paguaj shumën prej 300 €, dhe në emër të kompenzimit të viktimave të krimit shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

- Prokuroria Themelore në Prizreni, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, t'a ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe atë përkitazi me vendimin mbi dënim, dhe t'i shqiptoj dënim meritore më të rëndë, duke vlerësuar drejt të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

- Mbrojtësi i të akuzuarit M.S, av. Forti Skoro, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarit M.St'i shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim, PPA/I.nr.623/2024, të datës 21.11.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore - Departamenti i Krimeve të Rënda në Prizren, të ushtruar ndaj aktgjykimit të i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.65/2024, të datës 30.09.2024, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më i lartë me burg, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, M.S, av. Forti Skoro, të refuzohet si e pa bazuar.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, u caktua dhe u mbajt seanca e kolegjit në të cilën prezantuan: përfaqesuesi i të dëmtuarës-Agjensioni për Regjistrim Civil (ARC), Mentor Breca, i akuzuari M.S, dhe mbrojtësi i tij, av. Forti Skoro, ndërsa nuk prezantoi Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tij. Përfaqesuesi i të dëmtuarës-Agjensioni për Regjistrim Civil (ARC), Mentor Breca, deklaroi se e mbeshtetë dhe pajtohet me cilindo vendim të gjykatës, dhe se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike. Avokati Forti Skoro pasi që elaboroi pretendimet ankimore deklaroi se qëndron pranë propozimit të bërë në ankesë që të akuzuarit M.St'i shqiptoj një dënim më i butë. I akuzuari M.S.deklaroi se mbeshtet pretendimet ankimore dhe propozimin e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të prokurorisë dhe mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesat nuk janë të bazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë

Prokuroria Themelore e Prizrenit, në ankesë ka thekësuar se gjykata shkallës së parë nuk ka caktuar drejt lartësinë e dënimit, veçanërisht rrethanat e listuara në aryetim, ku si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar dy herë pranimin e fajësisë dhe pendimin për veprimet e marra nga i akuzuari. Për Prokurorinë nuk është e qartë se si gjykata e ka cilësuar si rrethanë lehtësuese moshën e të akuzuarit ngase i njëjti nuk është as i moshuar, as i rritur i ri, por i moshës 37 vjeç,

se gjykata ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, dhe ka nënvlerësuar ato rënduese, duke mos vlerësuar fare qëllimin e dënimit siç është preventiva. Gjykata për të aplikuar nenin 71 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, fillimisht është dashur të ekzistojë kushti bazik që është ekzistimi i rrethanave posaçërisht lehtësuese, e që në rastin konkret si mund të ekzistoj kur rrethanat rënduese peshojnë mbi ato lehtësuese, se pranimi i fajësisë nga i akuzuari nuk është dashur të merret si rrethanë posaçërisht lehtësuese, për faktin se i akuzuari Murat Shala ka qenë edhe më parë i dënuar për veprë penale të njëjtë po ashtu të cilën e ka kryer në vazhdimësi. Bazuar në argumentet e lartpërmendura, gjykata e shkallës së parë është dashur që të akuzuarit Murat Shala, t'i shqiptoj një dënim më të ashpër, i cili do t'i përgjigjej në masë të madhe shkallës së përgjegjësisë penale dhe rrethanave në të cilat janë kryer veprat penale nga ana e tij, andaj nga të lartcekurat, ka propozuar si më lartë.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit

Mbrojtësi i të akuzuarit Murat Shala, av.Forti Skoro, në ankesë ka theksuar se gjykata nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese siç e parasheh dispozita ligjore nga neni 69 par.3 të KPRK-së, dhe nuk i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese në mënyrë të duhur që shkojnë në favor të akuzuarit. Gjykata si rrethanë rënduese e ka cilësuar dashjen e cila është kryer me këmbëngulësi, e të cilën mbrojtja nuk e cilëson si rrethanë rënduese, për arsye se dashja është element i veprës penale. Sipas mbrojtjes gjykata nuk ka vlerësuar drejtë dy veprat për të cilat akuzohet i mbrojturi i tij, sepse nuk është vërtetuar lakmia si element tejet lehtësues i veprës penale, dhe që i akuzuari ka qenë në lajthim faktik pasi që nuk e ka ditur që veprimet e tij janë elemente të veprave penale. Shton se nga rrethanat tejet lehtësueses si korrektësia e të mbrojturit të tij që nga fillimi i procedurës gjerë të përfundimi i saj, pendimi i thellë, premtimi se nuk do të kryej veprime të kundërligjshme në të ardhmen, pastaj edhe nga rrethanat personale dhe shëndetësore, janë plotësuar kushtet që të mbrojturit të tij ti shqiptohet dënim alternativ nga neni 46 par.1, nënpar. 1.1 të KPRK-së, dënim me kusht, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit sepse kemi të bëjmë me vepra penale të lehta dhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë edhe pse nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i

njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë aspekt çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (në fakt as që ka mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari ka pranuar fajësinë), kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në frymë të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata Apelit, gjen se pretendimet ankimore të prokurorisë për ashpërsim të dënimit me burgim dhe mbrojtësit të të akuzuarit për zbutje të dënimit, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, faktin se që nga fillimi ka pranuar fajësinë, dhe rrethana tjera lehtësuese si: sjellja korrekte e tij, pendimi i thellë, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryen veprë tjetër penale dhe moshën e tij. Ndërkaq si rrethanë rënduese gjykata ka marrë parasysh peshën dhe mënyrën e kryerjes së këtyre veprave penale e cila veprë është kryer me dashje dhe me këmbëngulësi, pasojat e kësaj veprë penale të cilat janë të mëdha pasi që me regjistrimin e këtyre personave si shtetas të Republikës së Kosovës për Republikën e Kosovës ka mundur që të rezultojnë shumë pasoja të ndryshme në aspekt të sigurisë dhe besueshmërisë, po ashtu si rrethanë rënduese mori faktin se i njëjti të gjitha këto veprime i ka ndërmarrë duke shfrytëzuar të dhënat e kolegut të tij në mënyrë të fshehtë si dhe faktin se i njëjti është recidivist i veprave të njëjta penale pasi që i njëjti është i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr.65/2019 i plotfuqishëm më datën 27.12.2019, për veprën penale, Falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434, i dënuar me dënim prej 1200 euro gjobë, andaj gjykata i shqiptoi dënimin unik me burgim, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmën të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Kolegji gjen se rrethanat e marra për bazë nga gjykata e shkallës së parë si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese drejtë janë aplikuar në rastin konkret, më përjashtim të rrethanës rënduese që gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë e që është dashja e të akuzuarit, e që këtë rrethanë

kolegji nuk e akcepton ngase kjo rrethanë nuk mund të vlerësohet si rënduese marrë për bazë faktin se dashja në rastin konkret është element i vet veprës penale, andaj kolegji nuk akcepton këtë rrethanë si rënduese nga se do të konsistonte në dyfishim të rrethanave dhe atë vet elementi i veprës penale do të vlerësohej edhe si rrethanë rënduese. Megjithatë marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese që i ka gjetur gjykata e shkallës së parë e të cilat ky kolegj i akcepton në raport me pretendimet e mbrojtësit si të tilla ato pretendime janë të pabazuara, pasi që rezulton se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që mbrojtësi i të akuzuarit i pretendon si lehtësuese, andaj, kolegji nuk akcepton pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit se nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese për të mbrojturin e tij. Po ashtu, kolegji gjen të pa bazuar edhe pretendimin e prokurorit se i akuzuari Murat Shala ka qenë edhe më parë i dënuar për veprë penale të njëjtë, është pretendim të cilit i ka dhënë përgjigje gjykata e shkallës së parë, e i cili tani nuk e justifikojnë shqiptimin e një dënimi me të ashpër.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmën, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.688/2024, datë 19.12.2024

B.profesionale

Anëtarët e kolegjit:

Kryetar i kolegjit,

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Xhevdet Abazi

Skender Çoçaj